



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Gjykimi i Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit, dhe Haxhi Shalës do të fillojë të enjten e ardhshme, 14 nëntor, në orën 9:30, me deklaratat hyrëse të Prokurorisë dhe dy ekipeve të Mbrojtjes. Gjatë deklaratave hyrëse, palët do të paraqesin argumentet e tyre, përfshirë provat që synojnë t'i parashtrorin për të mbështetur ato.

Në fillim të seancës të së enjtes së ardhshme, do të lexohet aktakuza dhe Kryegjykatësja do të informojë të akuzuarit për të drejtat e tyre, do të pyesë të akuzuarit nëse i kuptojnë akuzat kundër tyre dhe do t'u japë mundësinë për të konfirmuar vetëdeklarimet e tyre fillestare të pafajësisë.

Pasi të jenë lexuar akuzat në aktakuzë, Prokuroria do të ketë dy orë për të bërë deklaratën hyrëse, pasuar nga Mbrojtja e Januzit, së cilës i është caktuar një orë dhe Mbrojtja e Haxhi Shalës, së cilës i janë caktuar 30 minuta. Trupi Gjykues përcaktoi kohëzgjatjen bazuar në kërkesat e palëve.

Në përputhje me rregullat, Mbrojtja e Bahtijarit tha se parapëlqen ta bëjë deklaratën hyrëse pasi Prokuroria të përfundojë paraqitjen e provave dhe thirrjen e dëshmitarëve të saj.

Aktakuza pretendon se midis 5 prillit 2023 dhe 12 prillit 2023, z. Januzi dhe z. Bahtijari, me udhëzim të z. Shala, u takuan secili më vete me dëshmitarin në dy raste për ta nxitur atë që të tërhiqte dëshminë, ose të mos jepte dëshmi në proceset zyrtare para DHSK-së, ndër të tjera përmes kërcënimit të rëndë dhe premtimit për dhurata ose të ndonjë forme tjetër të përfitimit.

Të akuzuarit akuzohen për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe frikësim gjatë procedurës penale.

Fillimin e gjykimit të enjten e ardhshme, 14 nëntor, mund ta ndiqni në shqipë, serbishte ose anglishte, nëpërmjet transmetimit në faqen e internetit të DHS-së, me vonesë prej 45 minutash, ose nga galeria për publikun në ambientet e gjykatës.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 5 nëntor, Trupi Gjykues hodhi poshtë kërkesën e Prokurorisë për pranim si prova dëshmitë me shkrim të dy dëshmitarëve, sepse Prokuroria kishte parashtruar kërkesën pas kalimit të afatit për parashtrim.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, dëshmitari i 103-të dha dëshmi gjatë kësaj jave. Dëshmitari, Shukri Buja, dha dëshmi kryesisht në seancë të hapur, megjithëse disa pjesë të seancës ishin të mbyllura.





Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 1 nëntor, Prokuroria njoftoi Trupi Gjykes se nuk synon më të thërrasë 12 dëshmitarë nga lista e mëparshme dhe synon të paraqesë deklaratat e tetë dëshmitarëve me shkrim, në vend të dëshmisë gojore në sallë të gjyqit.

Në të njëjtin parashtrim Prokuroria theksoi se pas këtyre ndryshimeve, numri i dëshmitarëve që japin dëshmi në sallë të gjyqit në kuadër të paraqitjes së provave prej Prokurorisë është ulur në 43.

Prokuroria tha gjithashtu se pret, që deri në pushimin e gjykatës në dhjetor, të jetë në gjendje të njoftojë Trupin Gjykes lidhur me ndryshime shtesë për listën e dëshmitarëve.

Seanca e ardhshme në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* është caktuar për të hënë, 18 nëntor, duke filluar në orën 9:00 paradite.

